



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.10.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i procesverbalit.

Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9426, datë 6.10.2005 “Për mbarështimin e blegtorisë”. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Rakip Suli, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Robert Bitri, Dritan Bici dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Florion Mima, Endri Hasa, Lorenc Luka, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Agron Çela dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

Enea Hoti – drejtor, pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Festim Shytaj – specialist, pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Siç ju kemi vënë në dijeni, sot kemi për diskutim projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 9426, datë 6.10.2005 “Për mbarështimin e blegtorisë”.

Relator i këtij projektligji është zoti Baraj. Të ftuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kemi z. Enea Hoti dhe z. Festim Shytaj, të cilëve u uroj mirëseardhjen në komision.

Pa humbur kohë, fjalën e ka zoti Baraj, më pas përfaqësuesit e ministrisë dhe në fund do të procedojmë me pyetje dhe diskutime. Dakord me rendin e ditës?

Besnik Baraj – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji synon liberalizimin e veprimtarisë së ndërzimit natyror të kontrolluar. Kjo propozohet të bëhet me shfuqizimin e licencës “Ndërzimi natyror i kontrolluar (stacionet e ndërzimit natyror)” me kodin II.2.A.2.

Gjithashtu, projektligji, parashikon edhe detyrimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e ndërzimit natyror për të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie edhe kryerjen e kësaj veprimtarie.

Argumentimi për këtë ndryshim lidhet me reformën e derregullimit e cila synon liberalizimin e tregut për këtë veprimtaria, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, si dhe synon krijimin e lehtësirave për përmirësimin e klimës së biznesit.

Pas miratimit të këtij projektligji do të ndërhyhet edhe në VKM 538/2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit” për të shfuqizuar licencën për këto stacione ndërzimi.

Ndryshimi i propozuar do të ndikojë në krijimin e lehtësirave të mëtejshme për përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Atëherë, e mbyllim diskutimin mbi projektligjin. Kalojmë në votim.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Abstenim?

Miratohet në tërësi projektligji.

MBYLLET MBLEDHJA